

LIGJ
Nr.7375, datë 8.5.1990

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.6803, DATË 29.6.1983 “PËR HARTIMIN DHE
ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.6803, dtë 29.6.1983 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”, neni 1 ndryshohet si vijon:

“Buxheti i shtetit është pjesë përbërëse e planit të përgjithshëm financiar të shtetit. Nëpërmjet tij shteti socialist përqendron me plan burimet e nevojshme financiare dhe i shpërndan ato pa kusht kthimi, për të përmbushur funksionet e ngarkuara”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

“Buxheti i shtetit për të ardhurat dhe shpenzimet e veta mbështetet në treguesit e planit të përgjithshëm financiar të shtetit, që hartohet në përputhje me kërkesat e ligjeve ekonomike objektive të socializmit dhe me parimet e planifikimit socialist”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Burimi kryesor i të ardhurave të buxhetit të shtetit është ekonomia socialiste, si dhe të ardhurat që realizojnë institucionet e ndryshme me karakter shoqëror e kulturor për shërbimet që kryejnë me pagesë.

Në buxhetin e shtetit nuk përfshihet pjesa e burimeve financiare të ndërmarrjeve nga e ardhura e tyre neto dhe fondi i amortizimit që, sipas kompetencave të dhëna me dispozita të Këshillit të Ministrave, i përdorin me plan për të përballuar nevojat e zgjerimit të veprimtarisë së tyre ekonomiko-prodhuese”.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Plani i përgjithshëm financiar i shtetit dhe buxheti i shtetit, si pjesë përbërëse e tij, hartohen për periudha pesëvjeçare për treguesit më kryesorë e për çdo vit me tregues më të hollësishëm të të ardhurave e shpenzimeve dhe miratohen me ligj nga Kuvendi Popullor i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Buxheti miratohet për të ardhurat dhe shpenzimet për çdo këshill popullor të rretheve.

Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ka të drejtë të përdorë për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të rrethit 30 për qind të shumës së tejkallimit të planit vjetor të të ardhurave të buxhetit të tij, kur ky tejkallim vjen nga përmirësimi i treguesve ekonomiko-financiarë të ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore e institucioneve që veprojnë në juridiksionin e rrethit.

Në rastet kur të ardhurat e buxhetit nuk realizohen, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, gjatë procesit të zbatimit të buxhetit, merr masa të kufizojë edhe kryerjen e shpenzimeve të tij dhe, kur shumata nuk balancohet, nuk ka të drejtë të krijojë fond rezervë në buxhetin e viti pasardhës.

Viti financiar dhe buxhetor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor”.

Neni 5

Në nenin 17, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Këshilli i Ministrave vendos për financimin e shpenzimeve për një kohë deri në tre muaj ose, në raste të veçanta, ngarkon Kryesinë e tij të vendosë për financimin, kur buxheti i shteit nuk miratohet para fillimit të vitit që planifikohet”.

Neni 6

Në nenin 20 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Këshilli i Ministrave gjatë vitit bën përmirësime e ndryshime në treguesit e planit të përgjithshëm financiar dhe të buxhetit të shtetit ose, në raste të veçanta, ngarkon Kryesinë e tij për t'i bërë këto përmirësime e ndryshime, duke ruajtur përpjesëtimet kryesore ndërmjet treguesve financiarë dhe treguesve ekonomikë të planit të shteit, të miratuara nga Kuvendi Popullor”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1991.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA